

ENVER MUHAMETAJ

**GJERGJ FISHTA NË KËNDVËSHTRIMIN E SHKENCËS
LETRARE SHQIPTARE***

Në hullinë e përpjekjeve gjithnjë e më intensive, që po bëhen gjatë viteve të fundit, për një rishikim e rivlerësim shkencor sa më të saktë e objektiv të traditës sonë letrare, të injoruar, të nënvlerësuar ose të denigruar për shkaqe jashtëartistike gjatë 45 vjetëve të sundimit të diktaturës komuniste në Shqipëri, do të ishte me interes shkencor, mendoj, sidomos në rrafshin e metodologjisë të studimit të letërsisë sonë kombëtare, të këqyrej në vija të përgjithshme, se si është pritur, vështruar e gjykuar trashëgimia letrare e At Gjergj Fishtës, e këtij personaliteti të fuqishëm e kompleks të letrave shqipe, nga shkenca letrare shqiptare e tri periudhave të ndryshme historiko-letrare: e periudhës midis dy Luftërave Botërore, më saktë e periudhës nga fillimet e këtij shekulli (kur nis të zhvillohet vrullshëm veprimtaria letrare e Fishtës) deri në mesin e viteve '40, e periudhës së sundimit të rendit totalitar komunist (1945-1990) dhe e periudhës së vendosjes së demokracisë pluraliste që nis nga fundi i viteve '90 e këtej.

Ndryshimet e mëdha, herë-herë edhe të skajshme, që vihen re në gjykimet për veprën letrare të Fishtës, gjatë këtyre periudhave, kryesisht midis gjykimeve të shprehura gjatë periudhës së parë e të tretë dhe periudhës së dytë, vetëkuptohet, nuk janë vetëm çështje e evolucionit, e thellimit dhe e saktësisimit të përshkallëzuar të mendimit kërkimor, çka do të ishte normale dhe e natyrshme, por, para së gjithash e zëvendësimit arbitrar qysh në vitet e para të Pasluftës të disa metodave e kriterëve përgjithësisht shkencore të studimit e të vlerësimit të letërsisë me kriterin

* Ky studim, i konceptuar në tri pjesë, që i kushtohen çështjes së pritjes e të vlerësimit të veprës letrare dhe të personalitetit të Gj. Fishtës nga shkenca letrare shqiptare e tri periudhave të ndryshme të zhvillimit historiko-letrar të popullit tonë, ka qenë përfunduar që në muajin tetor të vitit 1996. Megjithëse 3/4 e redaksisë së atëhershme të studimeve letrare e miratuan botimin e kësaj pjese të parë të tij, redaksia e re e studimeve letrare, e emëruar pas mesit të vitit 1997, nuk e pa të arsyeshme ta botonte. Studimi botohet në trajtën e atëhershme, pa asnjë ndryshim, me përjashtim të ndonjë redaktimi të lehtë.

politiko-ideologjik të gjykimit të saj, me “metodën” e mbipolitizuar e të mbiideologjizuar të sociologjizimit vulgar, një “metodë” kjo jashtëletrare e joshkencore e studimit letrar. Sipas nesh, pikërisht me këtë shpjegohet, në radhë të parë, fakti i trishtueshëm dhe paradokset e hidhura që Fishta të paraqitet njëherësh shkrimtari më i lexuar e më i vlerësuar, si “patriarku i letrave shqipe” në njërën periudhë, konkretisht në gjallje dhe disa vjet pas vdekjes së tij, dhe shkrimtari më i anatemuar, më i blasfemuar, madje fare i “humneruar” gjatë një periudhe tjetër po aq të gjatë – periudhës së sundimit të diktaturës komuniste, ndërkohë që vitet e fundit – vitet e demokracisë e të mendimit të lirë shkencor, vepra letrare dhe personaliteti i tij i shumanshëm (letrar, artistik, kulturor, patriotik, fetar etj.) po rishfaqen e vështrohen, përgjithësisht, më afër përmasave e vlerave të tyre reale.

I

Është një fakt i njohur dhe i pranuar tashmë nga fishtologët se për kohën e vet, në saje të veprimtarisë së gjerë e të pasur letrare, të zhvilluar gjatë 4 dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit tonë, Gj. Fishta u shqua si shkrimtari më i madh e më prodhimtar i letërsisë shqipe të kësaj periudhe. Karakteri poliedrik i talentit të tij artistik dhe interesat e gjera kulturore, të shoqëruara me një aktivitet të dendur letrar, kulturor, politik, fetar etj. i dhanë mundësi të shfaqë në mënyrë të shumanshme aftësitë e veta jo vetëm si poet, por edhe si artist-pikturor, arkitekt e gojëtar, përkthyes, publicist, polemist, estet, kritik letrar etj.

Por dihet se më ndritshëm se në çdo lëmë tjetër, Fishta shkëlqeu si poet. Krijimtaria e tij poetike e pasur dhe e larmishme u shtri në të gjitha gjinitë letrare – në epikë, lirikë e dramatikë, - në lëmin e satirës, si dhe në disa nga llojet më kryesore të tyre. Ajo u njoh e u mirëprit, u studiua e u vlerësua në tërësinë e vet mjaft mirë e, ndonjëherë, tepër lart nga kritika jonë letrare, brenda dhe jashtë Shqipërisë, si dhe nga albanologët e huaj*,

* Këtu kemi parasysh studimet monografike të albanologut të njohur italian P.Fulvio Cordignano S.J. (megjithëse në këtë punim, studimet e albanologëve të huaj nuk janë bërë objekt shqyrtimi) : “Epopeja kombëtare e popullit shqiptar”, Pjesa e parë, Shkodër, 1925, 153 f. Po ai, *Vasha n’epopen kombëtare të popullit shqiptar: Tringa e Malcis*, Shkodër, Shtypshkronja Françeskane, 1940, 38 f., si dhe artikuj të veçantë të botuar në organe të ndryshme të shtypit.

duke lënë mbresa të pashlyeshme e duke ushtruar një ndikim të fuqishëm në masën e publikut.

Studimet e artikujt më të mirë (me pak përjashtime) të botuar me gjallje të poetit si dhe ato që u përgatitën me rastin e një-vjetorit të vdekjes së tij, u përfshinë në dy përmbledhjet e njohura tashmë, që dolën në dritë në fillim të viteve `40. Përmbledhja e parë¹, më e vëllimshmeja, është ndarë në katër pjesë, në të cilat Fishta vështrohet përkatësisht si “njeri”, si “letrar”, në vdekje e fill mbas saj, ndërsa në pjesën e fundit jepet gjykimi për të i shkrimtarëve vendas e të huaj. Përmbledhja e dytë² ngërthen, po ashtu, një sërë studimesh e artikujsh të autorëve shqiptarë e të albanologëve të huaj, që e trajtojnë krijimtarinë letrare të Fishtës, në aspekte të ndryshme e nga këndvështrime të veçanta e origjinale.

Sipas mendimit të përgjithshëm të studiuesve të artit poetik fishtjan, talenti i fuqishëm poetik i Fishtës u shfaq më me forcë e më madhërisht në llojin e poezisë epike, ku ai krijoi edhe kryeveprën e vet të mirënjohur “Lahuta e Malcis”, e vlerësuar me të drejtë, si eposi kombëtar i shqiptarëve. Për këtë arsye, analizës shkencore të kësaj vepre monumentale, ndriçimit e argumentimit të vlerave e të origjinalitetit të saj artistik si epepe kombëtare e popullit shqiptar ose e personazheve të saj të veçantë u janë kushtuar një varg studimesh e artikujsh³ me vlerë.

Midis këtyre studimeve spikat për thellësinë e gjerësinë e mendimit shkencor dhe metodologjinë adekuate të analizës punimi i E. Çabejit “Epika e Gjergj Fishtës”. Pa mohuar shtytjen e jashtme letrare (ndikimin e poezisë popullore sllavo-jugore e, sidomos, të veprës së françeskanit boshnjak, poetit G.Martiç) studiuesi, i mbështetur në metodën e kritikës gjenetiko-historike, e sheh burimin e epicitetit të “Lahutës...” te “ndjenja

¹ “At Gjergj Fishta (1871-1940)”. Numër përkujtimuer botue nëpër kujdes t’A.Benedikt Dema O.F.M., Botimi “Distaptur”, Tiranë, 1943, 583 f. Më tej vetëm “At Gj. F.”

² Gjergj Fishta. Botimi i revistës “Shkëndija”. Shtëpia Botonjëse “Luarasi”. Tiranë, pa vit botimi. Më tej vetëm “Gj. F.”

³ Ndër to përveç studimeve monografike të P.F. Cordignanos, mund të përmenden: E.Çabej, *Epika e Gjergj Fishtës*, “Gj. F.”, f. 31-40; H.Lacaj, *At Fishta epik, po aty*, f. 41-44; K.B.Ashta, *Përmbajtja epike e “Lahutës së Malcis”*. “Tomori”, 1943, 28 prill; L. Gurakuqi, *Il Liute della mentagna*, “Gj. F.”, f. 102-109; K. Cipo, *A.Fishta dhe “Lahuta e Malcis”*, “At Gj.F.”, f. 197-201; P. Gjeçi, *Një poem energjik: “Lahuta e Malcis”, po aty*, f. 202-205; A.P. Bardhi, *Si xuni fill “Lahuta e Malcis”, po aty*, f. 193-196; E.Koliqi, *Marash Uci*, “Shejzat”, 1967, nr. 9-12, f.441-450, etj.

epike e jetës”⁴, e cila është ruajtur e gjallë posaçërisht në veri të vendit, te veçoritë e temperamentit të poetit, te shpirti luftarak i popullit të vet dhe te natyra epike e lëndës së veprës – luftërat heroike të shqiptarëve nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar e deri te Konferenca e Londrës, për fitimin e lirisë dhe mbrojtjen e trojeve të veta nga copëtimi. Por merita artistike e Fishtës, sipas E. Çabejit, është se prej kësaj baze historike të veprës së vet poeti arriti të krijojë një “epope kombëtare”, e cila “nganjëherë i kalon kufijtë e Shqipërisë, duke qenë njëkohësisht në një farë kuptimi, edhe një epos ballkanik...”⁵

Përkundër zërave që e kanë përfolur Fishtën si poet lokalist, që u këndon bëmave njerëzore dhe mendësisë së një krahine të vetme, studiuesit e epikës fishtiane kanë theksuar “njësinë shqiptare”, frymën mbarëkombëtare të kryeveprës së poetit. Natyra e spikatur thjesht shqiptare e Fishtës dhe dashuria e thellë për Shqipërinë e vërtetë, etnike, si dhe popullariteti në rritje si poet kombëtar, e nxitën atë të zgjerojë botën e ngushtë të këngëve të para, duke shtuar pjesë me një brendi më fort nacionale. Në këtë mënyrë ai e ngriti veprën në sferën kombëtare, duke i dhënë asaj karakterin e një eposi kombëtar. Nga ana tjetër, duke e vështruar lëndën e një treve me optikë kombëtare, ai i jep veprës frymë e përmasa mbarëkombëtare. Prandaj, sqaron E. Çabej në studimin e tij, nuk na takon ta përflasim poetin pse ka marrë për lëndë të poemës së tij një trevë njerëzore gjeografikisht të ngushtë, sepse në botën e përshkruar prej tij njohin vetveten gjithë banorët e maleve shqiptare. Është, pra, njësia shqiptare, – gjithnjë sipas Çabejit – e cila ndrit së poshtmi nga çdo anë. Duke argumentuar të njëjtin mendim si dhe E. Çabej, A. Pipa vjen në përfundimin se Fishta “tregohet kështu një mendje e lavrueme qi naltohet mbi çdo provincializëm e veshtron me një sy largpamës”⁶.

H. Lacaj, duke dashur të përcaktojë origjinalitetin e “Lahutës”, vë në dukje edhe frymën shqiptare të saj, përshkrimin mjeshëtor në funksion të ideve të veprës të një bote fantastike e mitologjike krejt të veçantë, thjesht arbënore. At Fishta për të është veti geni epik i Shqipërisë.

Duke qenë se Fishta, i pajisur nga natyra me një talent poetik të shumanshëm, është shquar në krijimtarinë e vet të larmishme jo vetëm si një poet i madh epik, por edhe si një poet i fuqishëm lirik, vëmendja e

⁴ Shih: “Gj. F.”, f. 31.

⁵ *Po aty*, f. 34.

⁶ *Po aty*, f. 122.

mjaft studiuesve letrarë të periudhës së parë është prirë nga synimi për të përvijuar edhe profilin lirik të Fishtës-poet, veçantitë e lirizmit fishtjan në lidhje të ngushtë me idetë që e përshkojnë atë, si dhe karakterin e vlerën artistike të lirikës së tij. Është me interes e kërkon shqyrtim serioz në këtë rrafsh mendimi origjinal i lirikut të shquar L. Poradeci, i cili, ndryshe nga mjaft studiues të tjerë, që nuk e venë në dyshim natyrën e mirëfilltë epike të “Lahutës...” e quan këtë një “poem” çquarësisht epiko-lirik: epikë objektive ku ndërhyr në çdo rast pjesëmarrja e shpirtit të poetit, me derdhjet lirike të vetëkuptueshme dhe të pamunguarshme të tija”⁷. Madje, pikërisht në gërshetimin e forcës e të butësisë së ndjenjave dhe të emocioneve, në pleksjen e epizmit me lirizmin, sheh Lasgushi “esencën e gjithë poezisë së Fishtës... epizëm ose lirizëm ose dramatizëm qoftë”⁸. Por, në thelb, ai afrohet shumë me mendimin e përgjithshëm, kur pohon se ana “e vërtetë, e rëndë e stilit të Fishtës”, që shfaqet në forcën e dinamizmin titanik të poezisë së tij e që ai figurativisht e ka shprehur me fjalët “Shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar”, përbën “sasinë e madhe, që i përmbyt të gjitha, të veprës së tij siç është shfaqur kryesisht në *Lahutën e Malcis*”⁹.

L. Poradeci nuk mbetet i vetëm në synimin e tij për të vënë theksin në peshën e elementit lirik, madje edhe në eposin “Lahuta...”. Një koncept të afërt me këtë, edhe më të avancuar në këtë kahje, shpreh A. Pipa, i cili është i mendjes, në dallim nga shumë studiues të tjerë, se Fishta “*ishte n’origjinë një poet lirik, por i një lirizmi të fuqishëm, kryengritës, jo lotues e melankolik, por burrnuer..., një lirizëm luftarak*” si ai i Pindarit apo më mirë ai i Tirteut¹⁰. Arsyet e një lloj lirizmi të tillë studiuesi i sheh jo vetëm në misionin fetar të poetit dhe në ndieshmërinë e tij, por edhe në gjendjen e robëruar të Shqipërisë, në kohën kur çdo interes vetjak shuhej përpara madhështisë së idealit të përbashkët kombëtar. Për këto arsye lirizmi i tij flijohej për hir të epikës, që i shërbente ringjalljes e ndërgjegjësimit kombëtar dhe të satirikes që dërrmonte të keqen. Megjithatë, lirizmi te Fishta shfaqet jo vetëm në trajtën epike, por edhe në formë të pastër (si te “Një lule vjeshte”, “Gjuha shqipe” etj.). “Vargjet më të nalta të Fishtës janë – sipas tij - sigurisht, vargje lirike”.

⁷ *Po aty*, f. 21.

⁸ *Po aty*, f. 24.

⁹ *Po aty*, f.28.

¹⁰ *Po aty*, f.121.

Mendime dhe vëzhgime të holla me vlerë shkencore janë shprehur në këtë periudhë edhe për vendin e satirës në eposin letrar fishtian, për origjinalitetin estetik dhe poetikën e saj. Disa studiues janë të mendimit se vepra satirike dhe humoristike e Fishtës ngërthen vlera origjinale emocionale dhe estetike, të cilat, në përgjithësi nuk qëndrojnë më poshtë se vlerat e krijimtarisë së tij në lëmin e epikës, të lirikës e të dramaturgjisë. Por në shkrimet e disa kritikëve të tjerë gjen edhe mendime tepër vlerësuese për këtë degë të rëndësishme të krijimtarisë poetike të shkrimtarit. Kështu, mendoj se albanologu A.F. Cordignano e kapërcen ndoshta masën e një gjykimi realist, kur shprehet se “Pak kush, kujtoj, në letratyrë të marë botës ja del A. Fishtës si poet satirik, i cili me një fuqi të çuditshme therë e prekë aty ku dhemb e djeg”¹¹. Por nuk kanë munguar edhe studiues letrarë shqiptarë të periudhës në shqyrtim që i kanë vlerësuar lart e, ndoshta, i kanë zmadhuar disi vlerat e poezisë së tij satirike. Njeri syresh, K. Kamësi, është shprehur se “arti poetik i vertetë e sensibiliteti i Fishtës spikasin në shkallën më të naltë ndër poezit satirike”¹², ku shfaqet më qartas, sipas tij, humori e natyra ironike e poetit. I të njëjtit mendim, në thelb, është edhe A. Pipa, kur shkruan se meqë në epikën e Lahutës, duke u bërë interpret i ndjenjës së popullit, Fishtës i duhej të flijonte, dashur pa dashur, vrullin e tij vetjak, talenti i tij vërshon në satirë, e cila i përshtatej më mirë temperamentit luftarak të poetit¹³. Përkundër këtij fakti, edhe në studimet e periudhës së parë, për veprën letrare të Fishtës vihet re një shpërpjesëtim i dukshëm midis vlerave të spikatura artistike të satirës fishtiane, rolit të saj emancipues e edukues kombëtar dhe interesimit dhe vëmendjes së pakët të studiuesve të kohës ndaj saj. Në dy përmbledhjet e njohura me studime për jetën dhe veprën e Fishtës gjendet vetëm një artikull¹⁴ për satirën e poetit, kurse në disa artikuj të tjerë problemorë jepet edhe ndonjë gjykim për veprën e tij satirike¹⁵. Theksohet ndër të tjera, synimi “ndërtues e jo dërrmues” i

¹¹ Shih: “At Gj. F.”, f. 181.

¹² *Po aty*, f. 181.

¹³ “Gj. F.”, f. 120.

¹⁴ P. Gjeçi, *At Gjergj Fishta, poet satirik*, në: “Gj. F.”, f. 72-76.

¹⁵ Shih: E.Koliqi, *Fishta interpret i shpirtit shqiptar*, “Gj. F.”, f.52-54; A.Pipa, *Fishta: njeriu e vepra*, “Gj. F.”, f. 120, 122; K.Kamësi, *Vepra poetike e Fishtës dhe kritika*, “At Gj. F.”, f. 181-182; *At Gjergj Fishta, në dritën e veprave të tij*, “At Gj. F.”, f. 311-314; P.Benedikt Dema, *Mbasi diq At Gjergj Fishta*, “At Gj. F.”, f. 404-405, 416; P. Anton Harapi, *Shqyptari i madh*, “At Gj. F.”, f.53, etj.

talljes së Fishtës, vënia e fuqisë shpotare të tij, përfshi këtu edhe sarkazmin politik therës, në shërbim të idealeve të larta kombëtare e njerëzore, çka buron nga fisnikëria burrërore e natyrës së tij dhe forca e atdhedashurisë që e frymëzon atë edhe në krijimet e veta satirike. Veçantitë e humorit të Fishtës nga E. Koliqi shihen në shtjellimin e të gjitha llojeve të shpotisë në trajta të gjalla popullore e plot frymëzim dhe në alternimin e papritur të gazit të tij shpotar me fluturime lirike e, ndonjëherë, veshja e tij me ngjyra të ëmbla e ndjesi plot mall.

Talenti krijues i Fishtës u shfaq edhe në lëmin e gjinisë dramatike, por jo me atë forcë e shkëlqim si në gjininë epike e atë lirike e as si në lëmin e krijimtarisë satirike. Këtij vlerësimi i përmbahen, në përgjithësi, studiuesit¹⁶ e trashëgimisë fishtiane në këtë gjini. Një mendim të tillë ata e shprehin herë tërthorazi e herë me eufemizëm, ndonëse ndonjë prej tyre kalon edhe në një farë mbivlerësimi, kur citon gjykime superlative të ndonjë albanologu të huaj. Ky fakt mund të shpjegohet edhe me përvojën relativisht të varfër kombëtare në këtë gjini; një arsye tjetër mund të jetë edhe konstatimi i albanologut M. Lamerc, sipas të cilit, “drama nuk i ka interesuar gjer tani shqiptarët dhe akoma nuk është krijuar ndonjë dramë e rëndësishme...”¹⁷. Një shpjegim, në thelb, të përafërt me këtë të fundit, që e vë theksin te rrethanat e veçanta historike dhe kërkesat shpirtërore specifike që kushtëzohen syresh, jep edhe studiuesi H. Lacaj, kur sqaron se prodhimet e dramaturgëve shqiptarë (duke pasur parasysh edhe veprat dramatike të Fishtës) nuk mund të krahasohen me veprat e dramaturgëve të mëdhenj evropianë, sepse, sikundër janë të ndryshme cilësitë e kërkesat shpirtërore të popujve të ndryshëm, ashtu ndryshojnë në përshtatje me to edhe prodhimet letrare e artistike të tyre. Me këtë shpjegohet, sipas tij, fakti që Roma nuk pati atë shkëlqim të artit dramatik, sidomos në llojin e tragjedisë, gjë që ajo e plotësoi me kryevepra të një gjinie tjetër.

Megjithëkëtë, studiuesit e veprës dramaturgjike fishtiane bashkohen në mendimin se Fishta-dramaturg hedh “bazat e dramatikës shqiptare”¹⁸, se ai jep provat e para të dramës lirike dhe është ndër të

¹⁶ Analizës së prodhimit dramaturgjik të Fishtës dhe kontributit të tij në lëmë të teatrit i kushtohen kryesisht artikujt: Kolë Ashta, *Prodhimi dramatik i Fishtës*, në: “Gj. F.”, f.77-83; Dr. Henrik Lacaj, *At Fishta në dramatikë*, në: “At Gj. F.”, f. 250-256; Zef M. Harapi, *At Fishta në lamë teatrore, po aty*, f. 257-262.

¹⁷ Cituar sipas: S. Çapaliku, *Fishta satirik, vepër e cit.*, f. 9.

¹⁸ Shih: “Gj. F.”, f.77 dhe “At Gj. F.”, f. 251.

parët krijues që pasuron shumë kësisoj dramën origjinale shqipe. K. Ashta bën edhe një klasifikim në tre faza të dallueshme të krijimtarisë dramaturgjike të Fishtës, duke vënë në dukje edhe rritjen e tij si dramaturg, sidomos në fazën e tretë, me tragjedinë “Juda Makabe” dhe dramën “Odisea” dhe “Efigenija në Aulli”. Tragjedia “Juda Makabe” vlerësohet si një vepër organike e thurur mjeshtërisht, zhvillimi i saj është i thjeshtë e pa stoli retorike. Po ashtu, studiuesit janë të një mendimi, kur theksojnë se, megjithëqë, për sa i përket teknikës së artit dramatik, sidomos në pjesët tragjike dhe në melodramë, Fishta ecën në gjurmët e dramaturgëve grekë, ai fut në to frymën origjinale shqiptare, se kur përpunon lëndën e marrë nga arti i lashtë grek ai synon e ia arrin të shprehë vulën e personalitetit të vet si dramaturg shqiptar dhe, më gjerë, aspiratat e përpjekjet e popullit të tij për liri e drejtësi. Këtë frymë origjinale ata e vënë re edhe në komeditë e përshtatura sipas Molierit (“*I ligu për mend*” dhe “*Dredhit e Patukut*”), në të cilat pikëzohet me mjeshtëri jeta shoqërore e sidomos ajo familjare e qytetit të Shkodrës, ndonëse nga ana e thurjes u qëndrohet besnik veprave të komediografrit frëng.

Por fryma thellësisht origjinale e shqiptare e veprës letrare të Fishtës nuk është një tipar që shfaqet vetëm në krijimtarinë dramaturgjike të tij. Ajo mishërohet, madje edhe më thellë e më me mjeshtëri, në përmbajtje dhe në formë, në tërë veprën e tij epike, lirike e atë satirike. Ky është mendimi që bashkon thuajse pa asnjë përjashtim, të gjithë fishtologët. Dhe për të provuar këtë nuk do të nevojiteshin shumë shembuj e citime, pasi ato i gjen me bollëk në tërë veprën e Fishtës e në studimet për të.

Kjo frymë origjinale e shqiptare mishërohet natyrshëm në veprën e Fishtës falë aftësisë së poetit për t’u thelluar “me fuqi depërtuese të pa shoqe në lëndën shqiptare”¹⁹; ajo është rrjedhojë e njohjes së thellë të shpirtit karakteristik të popullit të vet, me virtytet e të metat e tij; i zotësisë për të shkrirë, sipas E.Koliqit, ndikimet e sipërstrukturat e ndryshme kulturore në flakën e prirjeve tipike shqiptare²⁰. S’ka dyshim se kjo frymë shqiptare në veprën e poetit është edhe rrjedhojë e forcës së madhe të atdhedashurisë që e frymëzon atë në krijimet e veta. Fishta e desh atdheun me tërë forcën e shpirtit të djegur nga malli i lirisë, ai i

¹⁹ Pashko Gjeçi, *Nji poem energjik “Lahuta e Malcis”*, në: “At Gj. F.”, f. 204.

²⁰ Ernest Koliqi, *Fishta, interpret i shpirtit shqiptar*, në: “Gj. F.”, f. 52.

këndon atdheut si hyjnisë, Atdheu për të është mbi gjithçka, për hir të idealit të lirisë e të pavarësisë së tij ai është gati të mallkojë edhe Evropën, të shuajë edhe fisin e vet, të guxojë t'i shprehë pakënaqësinë edhe krijuesit të gjithësisë e, madje, të bëjë fli edhe vetveten²¹. Në këtë mënyrë ai arrin të na paraqitet, shpjegon E. Koliqi, si një “poet i gatuar me brumë thjesht etnik”, që na dha trajtën më karakteristike të jetës thjesht shqiptare. Vepra e tij u bë kështu, sipas shprehjes së E. Çabejit, pasqyra besnike, fytyra e kthjellët e gjithë vërtetësisë etnike, trimërisë së ashpër, burrërisë luftarake, krenarisë raciale që ka mundur të ruajë gjer sot jeta shqiptare²².

Nga ana tjetër, fishtologët të ndryshëm të kësaj periudhe nuk kanë ngurruar të vënë në spikamë se Fishta mbeti “fetar i devotshëm”, besnik i misionit të Urdhrit Françeskan. Dihet se përfaqësuesit e këtij urdhri u shkrinë me popullin e vet dhe arritën të bëhen jo vetëm meshtarë të vlefshëm, por edhe adhurues e luftëtarë për lirinë e përparimin e atdheut të tyre. Veçanërisht Fishta diti të gjejë “pajtimin e detyrave të besimit me ato të atdhetarizms”²³. Për këtë arsye “Atme e Fe” në poezinë e tij përbëjnë një binom, ato janë si dy flatra që rrahin harmonikisht, sepse “një klerik shqiptar nuk mund t'ishte më shqiptar se Fishta”²⁴. Besimi fetar të cilit ai i ish kushtuar, nuk e pengoi poetin që t'i këndonte Atdheut e lirisë së tij me tërë forcën e shpirtit dhe që këtë besim ta rrethonte përherë me fytyrën e adhuruar të Atdheut. Feja e përqafuar kësi mënyre me idenë e Atdheut, po të shpreheshim me fjalët e Lasgushit-kritik-“përbën bipolaritetin e Qendrës tokësore-qiellore të zemrës së poetit midis nesh dhe për të cilën ay na la, si trashëgim, testamentin e tij të zjarrtë, me fjalët që na flasin në fundin e vetëdijes s'onë”:

Mâ mirë dekë nen dhe m`u kja,
Se me marre gjallë mbi dhé;
Per dhe t`vet kush dekë ka ra
Aj s`ka dekun, por ka le

(Lahuta e Malcis - Pater Gjoni)²⁵

²¹ Mark Ndoja, *Idealet karakterizuese në Lirikën e At Fishtës*, në: “At Gj. F.”, f. 204.

²² Eqrem Çabej, *Epika e Gjergj Fishtës*, në: “Gj. F.”, f. 35.

²³ A. Marin Sirdani, *Jeta e vepra fetare e At Fishtës*, në: “At Gj. F.”, f. 29.

²⁴ Arshi Pipa, *Fishta: Njeriu dhe vepra*, në: “Gj. F.”, f. 110.

²⁵ Lasgush Poradeci, *Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar*, në: “Gj. F.”, f.22.

Një ndër aspektet e veprës letrare të Fishtës, që ka tërhequr vëmendjen e fishtologëve të periudhës së parë është edhe lidhja e thellë organike e kësaj vepre me frymën e krijimtarisë popullore. Trajtimit të këtij aspekti gjatë periudhës në fjalë, me sa dimë, i është kushtuar vetëm një artikull²⁶. Megjithëkëtë, kjo anë trajtohet edhe në mjaft artikuj të tjerë, sidomos në studimet ku bëhet objekt analize vepra epike e Fishtës, në veçanti, kryevepra e tij epike “Lahuta e Malcis”²⁷.

Në artikullin e njohur të E. Çabejit për epikën e Gj. Fishtës, ndikimi i poezisë popullore në kryeveprën e poetit zërthehet thellë, me objektivitet shkencor e, njëherësh, në formë tepër të qartë e të kapshme. Studiuesi e sheh këtë ndikim si në *formën e jashtme*, në masën popullore të vargut të “Lahutës...” – në 8-rrokshin trokaik, në rrjedhën ritmike të tij që është po aq popullore (sa disa këngë të poetit, sikurse ndonjë këngë e N. Frashërit dhe e L. Poradecit janë bërë këngë popullore të vërteta), në figurat e artit poetik – në aliteracionet, asonancat, përsëritjet e vargjeve, inversionet, e, veçanërisht, në krahasimet që merren nga poezia e popullit ose nga jeta baritore shqiptare – ashtu edhe në *formën e brendshme* e në stilin e veprës. Përshkrimet lakonike, të hedhura me vija të shpejta, dialogët mjeshhtërisht të shkurtër e të gjallë, ndërtimi dramatik në vend të gjerësisë epike, veprimi i vullshëm në vend të përshkrimit etj., këto veçori dalluese të këngës popullore shqiptare i gjen bukur të mishëruara edhe në poezinë epike të Fishtës.

Por ndikimi i thellë i poezisë popullore në epikën fishtiane, gjithnjë sipas Çabejt, nuk e vë aspak në diskutim origjinalitetin dhe vlerat e saj të larta artistike. Pasi rithekson, në përfundim të analizës, se vepra epike e Fishtës “mbështetet pa dyshim mbi një themel popullor, te fryma e poezisë popullore”, më tej ai shkruan “Veçse pjesën e kësaj nuk duhet të çmojmë tepër lart. Lahuta e Malcis është së fundi vepër vetjake e poetit, vepër arti e plotë, e përsosur dhe e përkryer në vetveti”.

Mendimin mbi origjinalitetin artistik të “Lahutës...” e mbrojnë bindshëm edhe studiues të tjerë. K. Kamësi, duke kundërshtuar pikëpamjet që e paraqesin veprën fishtiane si një përmbledhje këngësh popullore të Maleve të Veriut, me disa përmirësime e shtesa, thekson se

²⁶ Fr. Konrad Gjolaj O.F.M., *At Fishta në përpjekje me poezinë popullore*, në: “At Gj. F.”, f. 241-249.

²⁷ Për këtë shih: E. Çabej, *Epika e Gjergj Fishtës*, në: “Gj. F.”, f. 37-40; Kolë Kamësi, *Vepra poetike e Fishtës dhe kritika, po aty*, f. 171-173; *Gjykime të prof. dr. N. Jolk mbi At Gjergj Fishtën dhe veprën e tij*, në: “At Gj. F.”, f. 488, etj.

Fishta, prej këngëve të popullit, si edhe poetët e tjerë epikë, ka nxjerrë frymëzimin, ka marrë sfondin historik dhe argumentin e episodeve. Por, si njohës i thellë i shpirtit e i jetës së shqiptarit të maleve dhe si zotërues i pashoq i gjuhës, ai ka ditur, me trillin e vet poetik, t'i përdorë aq bukur e me aq mjeshtëri fjalët e burrisë, namët, frazat e hijshme e shprehjet poetike të Malsivet, sa lexuesit t'i duket sikur dëgjon vetë popullin. Me fantazinë e vet krijuese ai ka mundur t'i lidhë faktet historike me atë mënyrë jete të natyrshme e atë thjeshtësi zakonesh, me ato elemente legjendare e qeniesh mitologjike, që gjenden ende në shpirtin e malësorëve, sa t'i dhurojë popullit të vet një epike kombëtare, ndërsa letërsisë shqipe një kryevepër arti²⁸. Me fjalë të tjera, brumit popullor Fishta, me forcën e artit të tij, arriti t'i veshë “petkun e madhnueshëm t'originalitetit”²⁹.

Çështja e gjuhës, e bukurisë, e pasurisë dhe e shprehësisë së saj të veçantë artistike në veprën letrare të Gj. Fishtës si dhe e kontributit të këtij të fundit në pasurimin e saj, nga njëra anë, dhe e vështirësisë së saj relative për t'u kuptuar lehtësisht nga gjithë masa e shqiptarëve, nga ana tjetër, përbën një ndër çështjet relativisht më të trajtuara e më të diskutuara në shkencën tonë letrare të periudhës së parë, po të kemi parasysh se përveç dy³⁰ artikujve që i kushtohen tërësisht zbërthimit të kësaj çështjeje, nuk janë të paktë artikujt e tjerë³¹, disa prej të cilëve u përkasin personaliteteve më të rëndësishëm shkencorë e kulturorë të vendit ose albanologëve të huaj të asaj periudhe, që e prekin ose japin shkurt gjykimin e tyre edhe për këtë anë të veprës së poetit. Për kontribut shkencor në studimin filologjik të gjuhës poetike të Fishtës dallohen punimet e N. Resulit, të E. Çabejit e të K. Prelës.

N. Resuli në studimin e vet tërheq vëmendjen në ndihmesën e Fishtës në pasurimin e gjuhës poetike qoftë nëpërmjet futjes në poezi me

²⁸ K. Kamësi, *art. i cit.*, në: “At Gj. F.”, f. 172.

²⁹ Fr. Konrad Gjolaj O.F.M., *art. i cit.*, në “At Gj. F.”, f. 244.

³⁰ Shih: N. Resuli, *Gjergj Fishta dhe gjuha shqipe*, në: “Gj. F.”, f. 45-49; Kolë Prela, *Gjuha e Fishtës*, në: “At Gj. F.”, f.287-292.

³¹ Shih: E. Çabej, *art. i cit.* në: “Gj. F.”, f. 35; A.Xhuvani, në: “At Gj. F.”, f. 381; Prof. Karl Gurakuqi, *Jeta e veprat e Fishtës*, në: “Gj. F.”, f. 13-16; N. Jokl, *shkrim i cit.*, në: “At Gj. F.”, f. 490; Prof. Filip Fishta, *Për vdekjen e Fishtës*, në: “At. Gj. F.”, f. 357; P. Benedikt Dema, *Mbasi diq At. Gj. Fishta*, në: “At. Gj. F.”, f. 394; At Mark Harapi S.J., *Misjoni i Lartë i Poetit T'onë Kombëtar*, në: “At Gj.F.”, f. 518-520; Mark Ndoja, *art. i cit.*, në: “At Gj. F.”, f. 237; Kolë Kamësi, *art. i cit.*, në: “At Gj. F.”, f. 182, etj.

funksiione artistike, karakterizuese, të mjaft fjalëve të veçanta krahinore, qoftë nëpërmjet dhënies së një timbri vetjak e të një kuptimi të veçantë poetik shumë fjalëve të tjera, pa u larguar krejtësisht nga kuptimi i tyre origjinar. Duke shpjeguar, në rrafsh krahasues me Naimin, meritën e Fishtës në pasurimin e gjuhës, ai tregon ndryshimin rrënjësor në mes metodave të këtyre dy shkrimtarëve në përkujdesjen ndaj saj. Sipas mendimit të tij, ndërsa kujdesjet e Naimit janë më tepër të një linguisti purist, që do ta pastrojë shqipen nga fjalët e huaja, e për këtë, shtrëngohet të krijojë neologjizma të domosdoshme, Fishta, me kujdesin edhe të linguistit, po, sidomos të artistit, për të shprehur sa më me plasticitet e besnikëri ndjenjat, ngjyrat e veçoritë e shpirtit virgjin të malësorit shqiptar, nuk u kënaq me atë sasi fjalësh të përbashkëta që ka shqipja, por iu drejtua një brumi po aq virgjin – lëndës gjuhësore të veçantë të krahinës, duke futur i pari në poezi qindra fjalë të rralla krahinore, të cilat vetëm ose gati vetëm në një krahinë përdoren. Në këtë mënyrë, aftësia e tij shprehëse, pra, edhe arti i tij fitoi në saktësi e ndryshmëri, duke kurorëzuar një punë shekullore të letrarëve të Veriut e duke themeluar në këtë mënyrë edhe një shkollë të tijën në qarkun kulturor të Shkodrës. Por na duket se studiuesi bie në njëanshmëri, ku tërë vlerën e zotësinë artistike të At Fishtës apo “tërë të fshehtë e artit fishtjan” e sheh vetëm “te gjuha”, “te fuqia e mrekullueshme e shprehjes”, që atij i fali natyra, duke injoruar kësaj faktorët e tjerë, që përcaktojnë, krahas gjuhës, zotësinë artistike të një shkrimtari e vlerën artistike të veprave të tij.

Ndryshe nga N. Resuli, K. Prela, duke e shqyrtuar gjuhën e artit fishtjan si vis poetica, pra, në një rrafsh më të ngushtë, në rrafshin e veçorive konkrete të saj në veprën poetike të autorit, dallon si të tilla gjallërinë e thjeshtësinë, pa zbulurime retorike, të gjuhës së kësaj vepre, pasurinë e madhe të fjalorit poetik e të shprehjeve frazeologjike në të, dhe përdorimin e një “gjuhe vepruese” që është ndër karakteristikat e rapsodive popullore.

Nga një këndvështrim vetjak më profesional e më i gjerë, prof. Çabeji, pasi vë në dukje njëllotësinë e shprehjes gjuhësore të “Lahutës...” me të folurit e malësorit, çka mund të merret si një gjuhë e posaçme e një shtrese luftëtarësh, e vë theksin në origjinalitetin e gjuhës poetike të epikës fishtiane. Sipas tij, këtu kemi te bëjmë “me një gjuhë të krijuar prej poetit vetë, e cila si e tillë është gjuha e naltë, por njëkohësisht gjuhë popullore, e njëjtë me gjuhën e përditëshme”³².

³² E. Çabej, *art. i cit.*, në: “Gj. F.”, f. 35.

Një varg studiuesish, ndër të cilët edhe admirues të thellë të artit fishtjan, kanë vënë në dukje vështirësitë gjuhësore për të kuptuar poezinë e Fishtës, për shkak të përdorimit në të të shumë fjalëve të rralla krahinore. Studiues të tjerë u janë përgjigjur këtyre ankesave me argumentin se në kohën tonë nuk gjenden krahinat aq të largëta në gjuhë sa të mund të mos kuptohet kjo e fundit as prej profesorëve. Pastaj, si ka mundësi që gjuha e Fishtës të kuptohet edhe nga malësori më i humbur³³? Kurse kundërgumentit i Koliqit tingëllon edhe më bindës. Pasi përmend ndër poetët tanë më të mëdhenj edhe De Radën e Zef Skiroin, të cilët për shkak të dialektit na e japin pak si me vështirësi kënaqësinë poetike, ai sqaron se kjo vështirësi “asht faji i papërgatitjes së onë e jo i mungesës së fuqisë krijuese të tyre”³⁴.

Edhe pse nuk është bërë objekt qendror i studimeve të veçanta, stili i Fishtës, origjinaliteti i tij i theksuar, veçoritë e tiparet e tij më thelbësore kanë tërhequr vëmendjen e mjaft studiuesve³⁵ të veprës fishtiane. Do të ishte me interes të vihej në dukje përputhja e plotë, sigurisht, jo e rastit, e mendimeve të fishtologëve më kompetentë për karakteristikat kryesore të stilit të Fishtës. E. Çabeji e vështron poetin si krijues të një “stili epik të veçantë” të “Lahuta...”, veçoritë thelbësore të të cilit përputhen plotësisht në formë me veçoritë dalluese të poezisë popullore shqiptare. Të njëjtin mendim, në thelb, shpreh edhe Dr.N. Jokli, kur, pasi dallon si veçori thelbësore të të parave këngë të botimit origjinal të “Lahutës...” gjallërinë dramatike”, “shkurtësinë”, “fuqinë” e “përmbledhtësinë” e tyre, vëren, se ato i përshtaten stilit të këngës popullore shqiptare. Nëse Çabeji e cilëson stilin e “Lahutës...” “burrëror e të vrazhdë”, çka është në përshtatje me “trimërinë” e ashpër e “burrërinë luftarake” të malësorit shqiptar, L. Poradeci, përveç thjeshtësisë e natyralitetit, të zhveshur krejtësisht nga çdo hije retorike, dallon si veçori thelbësore të këtij stili “forcën”, “dinamizmin” titanik (“gjallërinë” të N. Jokli). Ai e quan stilin e “Lahutës...” stil “shkëmbor”, “të dheshmë”, “thelbësisht origjinal, të shkullur për rrënjë nga trupi dhe nga truri i racës...”. Për origjinalitetin e

³³ Shih: NICHTS, *Duhen rrënuë disa paragjykime të kalbuna - Lahuta e Malcis asht krenia e maleve t'ona të lira*. “Drita”, 1938, 6 Janar, f.1.

³⁴ E.Koliqi, *art. i cit.*, në: “Gj. F.”, f. 50.

³⁵ Për këtë çështje shih: E. Çabej, *art. i cit.*, në: “Gj. F.”, f. 35; Anton Harapi, *Shqiptari i Madh*, në: “At Gj. F.”, f. 55; Emz. Gjergj Velaj, *Kujtim i Patër Gjergjit*, në: “At Gj. F.”, f. 462; Kolë Ashta, *Prodhimi dramatik i Fishtës*, në: “Gj. F.”, f. 82; Pjetër Meshkalla, *Poeti i Kombit*, në: “Tomori i vogël”, 1943, nr.1, f.5, etj.

spikatur të stilit fishtjan janë të një mendjeje, siç u vu në dukje, të gjithë studiuesit e veprës se tij poetike.

Duke e vështruar këtë aspekt në mënyrë tërësore, N.Resuli e P. Harapi shprehin pikëpamjen se për sa i përket stilit e mënyrës së të shkruarit, Fishta krijoi një shkollë të vetën, që do të bëhej një traditë e qëndrueshme në qarkun letrar të Shkodrës. I këtij mendimi është edhe Çabeji, kur parasheh se te ky stil epik i veçantë fishtjan do të mbështetet medoemos çdo krijim epik i mëvonshëm në gjuhën shqipe e sidomos gegërishte.

Në tërësinë e gjykimeve e vlerësimeve për veprën letrare të Fishtës, për vendin e tij në letërsinë shqiptare, për përmasat e personalitetit të tij poliedrik, gjatë kësaj etape të shkencës letrare ka pasur, pa dyshim, edhe mbivlerësime, vlerësime e cilësime superlative, ndonjëherë edhe stërzmadhime e himnizime. Një pjesë e këtyre mund të jenë edhe shprehje e shijes letrare individuale ose e dëshirës për të evidentuar e vlerësuar sa më lart personalitete letrare e kulturore të vendit, në një kohë kur armiqtë e tij mohonin aftësitë krijuese të popullit shqiptar. Në disa nga ato mund të kenë ndikuar, përveç prodhimitarisë së gjerë e me nivel të lartë artistik të poetit, edhe përmasat, denduria dhe rëndësia e veprimtarisë së tij atdhetare, kulturore, politike, fetare etj., forca imponuese e personalitetit të tij të shumanshëm e të jashtëzakonshëm. Por disa nga këto mbivlerësime mund të jenë nxitur, ndoshta, edhe nga motive të tjera jashtëletrare e jashtëshkencore. Ato, sigurisht, nuk ndihmojnë në argumentimin e ndriçimin shkencor të kontributit e të përmasave reale të personalitetit letrar të Fishtës, por i mjegullojnë ato.

Janë të njohura pasuria e madhe e bukuria origjinale e gjuhës artistike në veprat e Fishtës, por zor se pranohet mendimi se “ai që i pari ndër poetët shqiptarë që e ngriti gjuhën tonë t’ëmbël shqipen ndër sferat më të larta të artit...”³⁶ Tingëllon i besueshëm vlerësimi se Fishta nuk ishte vetëm një poet epik klasik, por edhe “mjeshtër e artist i vërtetë edhe në poezinë lirike”³⁷. Veç na duket se kalohet masa e një gjykimi realist, kur pohohet se “... kaq asht kjarësia e bukurisë së lyrikës subjektive të Fishtës, sa qi ... nuk mund t’u gjejmë shoqen në lyrikën moderne...”³⁸. Është i argumentuar e i mbështetur në vlerat e larta artistike të satirikës fishtiane vlerësimi se Fishta ishte një “satirik i madh”³⁹, mund të

³⁶ N. Resuli, *Gjergj Fishta dhe gjuha shqipe*, në: “Gj. F.”, f. 45.

³⁷ Kolë Kamësi, *artik. i cit.*, në: “At Gj. F.”, f. 179.

³⁸ Mark Ndoja, *artik. i cit.*, në: “At Gj. F.”, f.238.

³⁹ Dr. N. Jokl, cituar sipas S.Çapaliku, *Fishta satirik, vepër e cit.*, f.9.

pranohet edhe mendimi i disa studiuesve, se “arti i vërtetë e sensibiliteti i Fishtës spikasin në shkallën më të lartë ndër poezitë satirike”⁴⁰. Por nuk ngjan të jenë po kaq të argumentuara e të mbështetura edhe mendimet sipas të cilave satira fishtiane “asht kryevepër botnore, e qi ... nuk e ka shoqen as n’atë të Horacit e në daçi n’atë të Tirteut...”⁴¹, apo se në të ka “copa të njëjti arti, qi s’e ka shoqen në letërsinë botnore për nga shufra e satyrës”⁴². Është pranuar, përgjithësisht, nga opinioni shkencor i kohës kontributi modest i Fishtës në lëmin e dramatikës në krahasim me arritjet e tij të shquara në fushën e gjinive të tjera letrare. Nga ky këndvështrim, pohimi se “veprat teatrale të Fishtës, të botuara “gjatë këtyre vjetëve (deri më 1909 –E.M.) janë vërtet klasike...”, se “At Fishta ia kalon Goldonit për gjallsi të dhjalogut, natyrsi të karakterit, stil populluer e sidomos për kah pastrija e gjuhës e mndyrës së thanjeve”⁴³, bie ndesh me atë gjykim pak a shumë të kristalizuar e të konsoliduar. Duket i matur e i mirëpeshuar mendimi i një njohësi të thellë e të hollë të poezisë shqipe e të artit poetik në përgjithësi, si E. Koliqi, mendim sipas të cilit poetët tanë të mëdhenj janë Naim Frashëri, Çajupi, Ndre Mjeda e Fishta⁴⁴ si edhe De Rada e Skiroi ose, kur në një studim të mëvonshëm, pasi e ngushton rrethin e të mëdhenjve, e vë Fishtën përbri De Radës e N. Frashërit, por nuk ngjan të jetë i tillë ose, të paktën, do të kërkonte studime të thella e të gjera në rrafshin krahasues të brendshëm vlerësimi superlativ për Fishtën si “shkrimtari më i madh i kombit të vet”⁴⁵, si “ma i madhi Poet Kombtar, qi njohti bota shqiptare deri më sot”⁴⁶, apo se ai “qe i vetmi gjer die ... që mund t’a përfaqësonte kombin shqiptar, pa frikë zvogëlimi, në rrethin e mbyllur të letraturave më të shkëlqyera të Evropës”⁴⁷. Tingëllon bindëse për kohën përqsja në rrafsh letraro-krahasues ballkanik e S.Malëshovës, i cili që më 1919 pohonte se “Ndër letrarë t’onë të gjallë lulzon në letratyrë e qi s’dron të përkraket (krahasohet – E.M.) me ç’farë do letrari tjetër të shteteve të Ballkanit, At Gjergj Fishta, mendes së të cilit Shqipnija ia din vjershat ma të bukura epike, lirike e

⁴⁰ Kolë Kamësi, *art. i cit.*, në: “At. Gj. F.”, f. 181.

⁴¹ Prof. Filip Ndocaj në: “At. Gj. F.”, f. 400.

⁴² Po ai, *po aty*, f. 406.

⁴³ Zef Harapi, *At Gjergj Fishta në lamë teatrore*, “Hylli i Dritës”, 1931, nr.10, f. 566.

⁴⁴ Ernest Koliqi, *Fishta interpret i shpirtit shqiptar*, në: “Gj. F.”, f. 50.

⁴⁵ Fr. Agustin Gemeli, O.F.M., në: “At Gj. F.”, f. 357.

⁴⁶ Prof. Filip Fishta, *Për vdekjen e At Fishtës*, në: “At Gj. F.”, f. 357.

⁴⁷ Namik Resuli, *art. i cit.*, në: “Gj. F.”, f. 45.

dramatike”⁴⁸. Po aq mbushamendës është edhe arsyetimi se At Fishta nuk na paraqet kryevepra si ato të Dantes, Gëtes apo të Shekspirit jo se i mungoi zotësija të ngjitet në lartësinë e tyre, por sepse e kuptoi që Shqipëria kishte nevojë për tjetër gjë dhe ai i vuri vetes tjetër mision⁴⁹. Por nuk do të ishte po aq mbushamendës e i besueshëm cilësimi i Fishtës si “Gjeni” e përbotshme”⁵⁰, para se të provohej shkencërisht një tezë e tillë në studime të tëra e serioze në rrafsh letraro-krahasues botëror. Vallë a e ndihmon përparimin e mendimit shkencor-letrar për Fishtën, a sjell ndonjë element të ri në këtë fushë përcaktimi superlativ i tij si “Ati i Parë i poezisë shqiptare”? A nuk lëshon hije ky pohim mbi traditën e shquar poetike pararendëse, sidomos asaj të periudhës së Rilindjes, gjurmëve të së cilës eci edhe Fishta i madh? Si patriarku i letrave shqipe gjatë 40 vjetëve të para të këtij shekulli dhe si një ndër shkrimtarët më të mëdhenj shqiptarë krahas De Radës e Naimit, Gj. Fishta nuk ka nevojë për mbivlerësime e himnizime. Shkrimtarët e mëdhenj të një kombi nuk i bëjnë kurrë hije njeri-tjetrit. Secili është i madh për kohën e vet, me kontributin e vet origjinal në progresin artistik, ndërgjegjësimin kombëtar dhe emancipimin shpirtëror të kombit të vet, me vlerat e karakteristikat e tij specifike, me vendin e rolin e tij të veçantë në historinë e letërsisë e të kulturës shqiptare.

Madhështia e personalitetit poliedrik të Fishtës gjatë periudhës që po analizojmë nuk ua ka ndrydhur kurajën studiuesve të ndryshëm, midis të cilëve edhe admiruesve të flaktë të poetit, për të treguar disa mangësi e të meta të veprës së tij letrare. N. Resuli, një ndër studiuesit më kompetentë e admiruesit më të thellë të Fishtës, ka vënë në dukje se vepra e tij, megjithë thesaret e paçmueshme që ruan në vetvete, nuk iu shmang dot të metave të tilla si disa përsëritjeve të tepërta dhe një farë “proliksiteti”, që e bën atë herë-herë monotone, se frymëzimi e ndjenja, sidomos në veprën e tij epike, mbasi lënda është e gjerë, nuk e ndjekin poetin deri në mbarim të vjershës dhe atëherë qit kryet retorika⁵¹. Një tjetër studiues e admirues i veprës së Fishtës, P. Meshkalla, përveç mangësive të mësipërme, përmend dhe “tjerrjet e pambarim të përshkrimevet” dhe “stilin e vrazhdë e breshtak” të “Lahutës...”. Veçse

⁴⁸ Sejfulla Malëshova, *Shënime të shkurtëra për letretyrën shqipe*, “Agimi”, 1919, Qershuer, Vjeti I, nr. 2, f.20.

⁴⁹ Pjetër Meshkalla, *Poeti i Kombit*, “Tomori i Vogël”, 1943, nr.1, f.5.

⁵⁰ Injac Zamputi, *At Gjergj Fishta gjeni shqiptare, gjeni botnore*, në: “At Gj. F.”, f. 537.

⁵¹ Namik Resuli, *art. i cit.*, në: “Gj. F.”, f. 46.

këto të meta, sipas tij, nuk i përkasin autorit, por karakterit heroiko-popullor të rapsodive, të cilave poeti u qëndroi mrekullisht besnik. Ky shpjegim nuk të bind plotësisht, po të kemi parasysh se edhe vetë Fishta ishte i vetëdijshëm për zgjatjet te “Lahuta...”, kur në çastet e fundit të jetës, kishte folur për një “shkurtrim” të saj dhe kur edhe një miku të vet (V. Volajt) i kishte folur për shkurtrim të këngës së parë⁵² të kësaj vepre.

Studiues të tjerë kanë paraqitur si të metë të “Lahutës” “fragmentaritetin e dukshëm”⁵³ si dhe “lidhjen e dobët” ndërmyjet këngëve të saj, lidhje e cila në trajtën përfundimtare të vitit 1937, me ndryshimet e shtesat e bëra nga autori, forcohet e, për rrjedhojë, vepra fiton mjaft në njësi veprimi. Por, lidhur me këtë të metë E. Çabeji shpjegon se në themel qëllimi i poetit nuk ka qenë të krijojë një poem me një veprim kryesor të vetëm dhe me një hero kryesor, sepse në vepër spikatin një varg heronjsh dhe se gjithë populli i malësisë është heroi anonim i veprimit epik⁵⁴.

Kurse në lidhje me reminishencat sllave në veprën e Fishtës, E. Çabeji sqaron me plotë të drejtë se këtu kemi të bëjmë më fort me një model, me një të hequr të vërejtjes drejt pasurive të njëjta te vatra e vet sesa me një ndikim poetik të thellë⁵⁵. Edhe imitimet e asimilimet e shumta prej letërsive të huaja, italiane etj., sipas një studiuesi tjetër marrin ngjyrën fishtiane, sa mund të thuhet me plot gojën se janë bërë të tijat⁵⁶.

Disa studiues të kësaj periudhe, nisur nga shtrirja e ngushtë gjeografike-kombëtare që vihet re, ndonjëherë, në disa krijime të tij poetike ose nga vështirësitë relative gjuhësore që paraqet vepra e poetit, e kanë identifikuar këtë me frymën e ngushtë lokaliste. S. Luarasi, në një punim të vetin, pasi ve në dukje se At Fishta do të ecte në rrugën e çelur nga Naimi, më tej shprehet: “Disa, megjithëkëtë, shohin një dallim thelbësor midis tyre: ndërsa njeri, Fishta i zhvillon subjektet e veta me një frymë regjionaliste të theksuar, ... tjetri, Frashëri i shtron vetes për detyrë që në veprat e veta të shprehë shpirtin e mbarë popullit shqiptar, pa dallim krahine ose fisi, atë që njeri e humbet në gjerësi, tjetri e fiton në

⁵² A. Viktor Volaj, *Sëmundja e deka*, në: “At Gj. F.”, f. 345.

⁵³ Prof. F. Ndocaj, *Nga fjala e mbajtur për At Fishtën në Konferencën e organizuar më 9 Fërrier 1941 në kinemanë Rozafat*, në: “At Gj. F.”, f. 401.

⁵⁴ E. Çabej, *art. i cit.*, në: “Gj. F.”, f. 34.

⁵⁵ Po ai, *po aty*, f. 32.

⁵⁶ Pjetër Meshkalla, *art. i cit.*, “Tomori i vogël”, 1943, nr.1, f.5.

thellësi”⁵⁷. Studiues të tjerë e kanë quajtur të pambështetur këtë vërejtje dhe, nëpërmjet krahasimit të mënyrës me të cilën shprehet koncepti i Kombit e kombësisë të këta dy poetë të mëdhenj, kanë sqaruar se kjo mënyrë shprehjeje është e ndryshme të njeri e të tjetri. Ndërsa syri i Naimit të mërguar i vështron barabar me përmallim të gjitha viset e bukura të Shqipërisë etnike, me Fishtë, ndodh ndryshe. Për të epiqendra e idesë shqiptare është Shkodra, por kjo ide, kjo frymë kombëtare, ashtu si rrathët koncentrikë, nisin prej Shkodre për t’u bërë gjithnjë e më pak të dukshëm sa më shumë të largohen prej saj. E rëndësishme e thelbësore është, sipas tij, se krijimet e shumta të Fishtës e përmbajnë kudo farën e Shqiptarizmit, ato frymëzohen nga ideali i lartë për atdheun etnik, se kontributi i Fishtës në krijimin e ndërgjegjes kombëtare është shumë i madh dhe se “gjurmët e regjionalizmit zhduken gati krejt në veprën që përfshin në tërësinë e saj, të gjithë kombin shqiptar”⁵⁸.

Duke mbajtur parasysh, nga njëra anë, se edhe vepra e Fishtës, si e çdo poeti tjetër të madh, ka se ku të kritikohet (le të kujtojmë thënien se ndonjëherë edhe Homeri fle) dhe nga ana tjetër, duke e vështruar veprën e tij në tërësi e në frymën e vet, nuk mund të mos pajtohesh me gjykimin e përgjithshëm se “Në tonalitetin” e saj vepra e Fishtës është përsosur, është nga më të përsosurat e letërsisë sonë, sasia e të metave në proporcion nuk e kalon atë të çdo kryevepre tjetër të huaj dhe kjo ka rëndësi”⁵⁹, apo si kundër shprehet një tjetër studiues fishtjan, “... para bukurisë së përgjithshme të Lahutës, disa të meta të vogla mbulohen dhe falen”⁶⁰.

Nëse studimet e kësaj periudhe për veprën letrare të Fishtës, do t’i shqyrtonim nga pikëpamja e tipologjisë dhe e llojshmërisë së tyre, të bie menjëherë në sy se tipet më të përhapura janë: tipi i studimit historiko-letrar sintetizues ose të përgjithshëm, që trajton en bloc prodhimtarinë letrare të shkrimtarit në lëmë të gjinive të veçanta letrare e, në kuadrin e këtij tipi, lloji i studimit historiko-letrar analitik, që i kushtohet zbërthimit të vlerave artistike të ndonjë vepre të veçantë ose analizës së tipareve dhe domethënies së ndonjë personazhi kryesor të saj (Marash Uci, Tringa). Pastaj vjen tipi i artikullit shkencor problemor, që bën objekt trajtimi

⁵⁷ S. Luarasi, *La litterature moderne en Albanie*, “Revue Internationale des Etudes Balkaniques”, Beograd, 1936, Tom III-IV, f. 553.

⁵⁸ Jakov Milaj, *Farkëtari i ndërgjegjes kombëtare*, “Tomori i Vogël”, 1943, Viti II, nr. 1, f. 1,8.

⁵⁹ N. Resuli, *art. i cit.*, në: “Gj. F.”, f. 46.

⁶⁰ Nikollë Dakaj, *Një titull i merituem*, “Tomori i vogël”, 1943, nr.1, f.6.

çështje a probleme të caktuara të veprës letrare fishtiane (disa prej të cilave u cekën edhe në këtë punim).

Vend të rëndësishëm zë edhe studimi biografik, që ndriçon anët më të spikatura e më të rëndësishme të jetës e veprimtarisë letrare të poetit. Të shumtë janë në kuadrin e këtij tipi artikujt e shkrimet përkujtimorë, që japin mbresat personale nga njohja me Fishtën ose gjykime e vlerësime të përgjithshme, ndonjëherë tepër entuziaste dhe euforike të bashkëkohësve, për vlerat e krijimtarisë letrare të poetit dhe rolin e tij si edukator dhe misionar i kombit. Studimet monografike të natyrës historiko-letrare janë të pakta. Këtij tipi i përkasin, mendoj, studimet e njohura të albanologut të shquar italian A.F. Cordignano për “Lahutën...” si “epopeja kombëtare e popullit shqiptar” dhe për Tringën si një ndër personazhet më të realizuar artistikisht të kryeveprës fishtiane.

Studimet e mirëfillta krahasuese thujtse mungojnë krejt. Megjithëkëtë, në një varg punimesh e artikujsh shkencorë, i është kushtuar vëmendje edhe krahasimit të Fishtës - poet me poetë të tjerë të shquar të Rilindjes, veçanërisht me N. Frashërin dhe me Mjedën si dhe përfaqesës së “Lahutës” me eposin homerik etj. Janë vënë në dukje edhe pika takimi, tipare të ngjashme e ndikime të pjesshme të letërsisë klasike greke e të letërsisë italiane etj. me veprën letrare të Fishtës. Për arsye që kuptohen (rrethanat e vështira të luftës, që pamundësuan njohjen e dorëshkrimeve e të arkivit të shkrimtarit), në këtë etapë thujtse munguan studimet për historinë e krijimit të veprave letrare të Fishtës.

Të vështruara në tërësinë e tyre, studimet e kryera gjatë periudhës së parë arritën të ndriçojnë në vija të trasha momentet kryesore të jetës e të veprimtarisë letrare të Fishtës, në lidhje të ngushtë me përpjekjet e popullit shqiptar për çlirimin nga robëria turke dhe për formimin e konsolidimin e shtetit të vet të pavarur, për ndërgjegjësimin kombëtar, zhvillimin letrar e kulturor dhe emancipimin e vet shpirtëror. Këto studime kapën e trajtuan shkencërisht, ndonëse jo përherë në thellësinë e dëshiruar, disa nga problemet e anët kryesore të veprës së pasur letrare të shkrimtarit, pahësuan e argumentuan, shpeshherë me kompetencë profesionale e njohje të thellë të objektit, disa nga vlerat thelbësore e më karakteristike të krijimtarisë letrare të tij, duke evidentuar e theksuar posaçërisht veçanti të tilla të saj si origjinalitetin e spikatur kombëtar e frymën e thellë atdhetare, lidhjen organike me këngët popullore e traditën letrare pararendëse kombëtare, ballkanike dhe evropiane, gjuhën e pasur artistike, stilin origjinal e të goditur etj. Ato evidentuan qartë edhe rolin e veçantë të poetit në zhvillimin e pasurimin e gjuhës shqipe, kontributin e

tij të rëndësishëm në zgjimin e farkëtimit e ndërgjegjes e të krenarisë kombëtare, në ringjalljen e besimit e të shpresës për rimëkëmbjen e përgjithshme kombëtare të vendit, etj.

Në trajtimin shkencor të këtyre problemeve dhanë kontributin e tyre personalitete të tillë të njohur të shkencës, të letërsisë e kulturës shqiptare në tërësi, të asaj periudhe si E. Çabej, N. Resuli, E. Koliqi, A. Pipa, K. Gurakuqi, A. Xhuvani, K. Cipo, L. Poradeci, S. Spasse, P.A. Harapi, P.B. Dema, K. Ashta, H. Lacaj, M. Ndoja, J. Kodra, P. Gjeçi, J. Milaj, A. Ermenji, I. Zamputi, K.Kamësi etj. si dhe albanologë të huaj të mirënjohur si P. F. Cordignano, Dr. N. Jokli etj. Studimet e tyre dhanë ndihmesa origjinale e me vlera të spikatura për kohën dhe kontribuuan për të përfutur një përfytyrim të përgjithshëm të qartë e pak a shumë të plotë për vendin e poetit në lëvizjen letrare të kohës, për zhvillimin e pasurimin e letërsisë shqipe në tërësi dhe të mundësive shprehëse të gjuhës poetike në veçanti.

Kryevepra fishtiane “Lahuta e Malcis” e çmuar si epopeja kombëtare e popullit shqiptar dhe vetë autori i saj gëzoi e meritoi plotësisht, që në gjallje të tij vlerësimin e lartë dhe nderimin e madh të njihet me plot të drejtë si poet kombëtar i shqiptarëve.

(vijon në numrin e ardhshëm)

SUMMARY

GJERGJ FISHTA FROM THE POINT OF VIEW OF THE ALBANIAN LITERARY SCIENCE

In this study which has been divided in three parts, each one belongs respectively to three periods of historical-literary development of the Albanian nation. The first period reflects the beginning of the XX century (which is the mark for the birth of Gj. Fishta's literary work), followed by the second period of the mid 1940's, time during which Albania was under the totalitarian communist regime (1945-1990), leading to the third period which is characterized by the establishment of democracy in Albania beginning in the 1990's. Enver Muhametaj has targeted to present to us how the literary work of this multidimensional personality of the Albanian literature has been received and valued from the Albanian Literary Science during the previously mentioned periods.

On the first part of the study, published in this issue of the magazine, the author by basing his opinion mainly on the knowledge of studies and articles published on two well known works such as in 1941 and in 1943 (published in Shkëndija magazine) tries to present the personal impressions and views of well known Albanian critics and scientists of the first period, by studying the most essential parts of the work and the literary talent of Gj. Fishta such as: the illuminating and the argument of the values and the artistic originality as well as the authenticity of the brilliant work “Lahuta e Malcis” seen rightfully so as the national epos of Albanians; the analysis and the rating of the lyric profile of his powerful talent; the placement of of satire and humor in Fishta’s literary work, the valuing of the contribution of Gj. Fishta in national drama, the dismantlement of the deep connection between the literary work of the great writer with the creativity of the people, the discovering and the presentation of beauty, richness and unique artistic expression of the language in his work; the pronounced discovering of writer’s style. The studies and articles of this period also have been studied and classified from the point of their style and diversity.

Based on this analysis, the author reaches the argument conclusion that the researchers of the literary work of Gj. Fishta, with the help of their own original knowledge based on their studies, achieved a general, clear and full idea for the place of the writer in the movement of literary times, for his multidimensional contribution in the development and the enrichment of Albanian literature in general and of the expressive possibilities especially , deserving fully of the highest honor given to a poet during his life - National Poet of the Albanians.

